

C.nr. 691/ 18

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil me gjyqtaren Afijete Sada Gllgjani dhe procesmbajtësen Miranda Marku, në çështjen juridike të paditësve 1. A. S., 2. R. M., 3. M. M., 4. G. R., 5. Sh. N. 6. M. M. dhe 7. J. E. që të gjithë nga Gjakova të cilët i përfaqëson i autorizuari i SBASHK-ut B. Sh., kundër të paditurës K. Gj. D. A., kontest punë-kompensim të pagave për përcjellje në pension dhe shpërblim jubilar, vlera kontestit **18 046.76 €**, në shqyrtimin kryesor të mbajtur me datë 27 dhjetor 2018 në prezencën e të autorizuarit të paditësve e në mungesë të paditurës, murr këtë;

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht kërkesë padia e paditësit **A. S.** nga Gjakova dhe **DETYROHET** e paditura K. Gj. D. A. që paditësit të ia paguajë borxhin në emër të dy pagave përcjellëse në pensionim, sipas pagës mesatare për tre muajt e fundit dhe atë për muajt janar, shkurt 2015 nga 241.28€ shumën prej 482.56€ dhe për shpërblim jubilar sipas pagës bazë për tre muajt e fundit para pensionimi, dhe atë për një pagë në shumën prej 241.28€ gjithsejtë shumën prej 723.84€ (shtatëqindnjëzetëtri euro e tetëdhjetë e katër cent) dhe pagesën e shpenzimeve procedurale në shumë prej 30,00€ të gjitha në afatin prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

Kërkesa për muajin mars 2015 në shumë prej 241.28€ në emër të pagës përcjellëse në pension u **REFUZUA SI E PABAZUAR.**

II. DETYROHET e paditura K. Gj. D. A. që paditëses **R. M.** nga Gjakova të ia paguajë borxhin në emër të tri pagave përcjellëse në pensionim sipas pagës mesatare për tre muajt e fundit muajt prill, maj qershor 2016 nga 468.73€ shumën prej 1406.19€ dhe për shpërblim jubilar sipas pagës bazë për tre muajt e fundit nga 405.00€ shumën prej 1215.00€ gjithsejtë shumën prej 2621.19€ (dymijegjashtëqindnjëzetënjë euro e nëntëmbëdhjetë cent) dhe pagesën e shpenzimeve procedurale në shumë prej 40,00€ të gjitha në afatin prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

III. DETYROHET e paditura K. Gj. D. A. që paditëses **M. M.** nga Gjakova të ia paguajë borxhin në emër të tri pagave përcjellëse në pensionim sipas pagës mesatare për tre muajt e fundit qershor, korrik dhe gusht 2016 nga 445.31€ shumën prej 1335.93€ dhe për shpërblim jubilar sipas pagës bazë për tre muajt e fundit nga 405.00€ shumën prej 1215.00€ gjithsejtë shumën prej 2550.93€ (dymijepesëqind e pesëdhjetë euro e nëntëdhjetë e tre cent) dhe pagesën e shpenzimeve procedurale në shumë prej 40,00€ të gjitha në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

IV. DETYROHET e paditura K. Gj. D. A. që paditëses **G. R.** nga Gjakova të ia paguajë borxhin në emër të tri pagave përcjellëse në pensionim sipas pagës mesatare për tre muajt e fundit, muajin shkurt, mars, prill 2016 nga 473.91€ shumën prej 1421.73€ dhe për shpërblim jubilar sipas pagës bazë për tre muajt e fundit nga 405.00€ shumën prej 1215.00€ gjithsejtë shumën prej 2636.73€ (dymijegjashtëqindtridhjetegjashtë euro e shtatëdhjetë e tri cent) dhe pagesën e shpenzimeve

procedurale në shumë prej 40,00€ të gjitha në afatin prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

V. DETYROHET e paditura K. Gj. D. A. që paditëses **Sh. N.** nga Gjakova të ia paguajë borxhin në emër të tri pagave përcjellëse në pensionim sipas pagës mesatare për tre muajt e fundi, muajt prill, maj dhe qershor 2016 nga 462.00€ shumën prej 1386.00€ dhe për shpërblim jubilar sipas pagës bazë për tre muajt e fundit nga 405.00€ shumën prej 1215.00€ gjithsejtë shumën prej 2601.00€ (dymijegjashtëqind e një euro) dhe pagesën e shpenzimeve procedurale në shumë prej 40,00€ të gjitha në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

VI. DETYROHET e paditura K. Gj. D. A. që paditëses **M. M.** nga Gjakova të ia paguajë borxhin në emër të tri pagave përcjellëse në pensionim sipas pagës mesatare për tre muajt e fundit, për muajin mars, prill dhe maj 2016 nga 276.00€ shumën prej 828.00€ dhe për shpërblim jubilar sipas pagës bazë për tre muajt e fundit nga 276.00€ shumën prej 828.00€ gjithsejtë shumën prej 1656.00€ (njëmijë e gjashtë qind e pesëdhjetë e gjashtë euro) dhe pagesën e shpenzimeve procedurale në shumë prej 30,00€ të gjitha në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

VII. PJESËRISHT aprovet kërkesëpadija e paditëses dhe **DETYROHET** e paditura K. Gj. D. A. që paditëses **J. E.** nga Gjakova të ia paguajë borxhin në emër të tri pagave përcjellëse në pensionim sipas pagës mesatare për tre muajt e fundit gusht, shtator dhe tetor 2016 nga 274,65 shumën prej 823,95 € dhe për shpërblim jubilar sipas pagës bazë për tre muajt e fundit nga 274,65€ shumën prej 823,95 € gjithsejtë shumën prej 1647,90€ (njëmijë e gjashtëqind e katër dhjetë e shtatë euro e nëntëdhjetë cent) dhe pagesën e shpenzimeve procedurale në shumë prej 30,00€ të gjitha në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

II. Përtej shumës së aprovuar kërkesa në shumë prej 396,00 € u **REFUZUA SI PA BAZUAR.**

A r s y e t i m

Paditësit me padi, parashtrësia nëpërmjet të autorizuarit të tyre kanë parashtruar se kanë qenë në marrëdhënie të rregullt pune të e paditura dhe kanë punuar në cilësinë e mësimdhënësve dhe punëtorëve teknik atë deri në kohën e pensionimit. Pas pensionimit, paditësve ju ka takuar e drejta në tri paga përcjellëse, në lartësi të tri pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit dhe e drejta në tri paga jubilarë. Bazën ligjore të padisë e mbështesin në Kontratën Kolektive të Arsimit Parauniversitar të datës 11 prill 2014 sipas së cilës me dispozitat e nenit 36.9 thuhet “ Punëtorët që dalin në pension përfitojnë shpërblim jubilar në vlerë siç vijon;

- 7.1 për 10 vjet të përvojës së punës të punëdhënësi i fundit në vlerë të një page bazë,
- 7.2 për 20 vjet të përvojës së punës të punëdhënësi i fundit në vlerë të dy pagave bazë,
- 7.3 për 30 vjet të përvojës së punës të punëdhënësi i fundit në vlerë të tri pagave bazë,
- 7.4 punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblimin jubilar,
- 7.5 Shpërblimet jubilar paguhen nga punëdhënësi në afatin prej 1 muaji pas plotësimit të kushteve”.

Më tutje sipas dispozitave të nenit 36.10 “ Punëtorët që dalin në pension përfitojnë pagesë përcjellëse në lartësi të tri pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit.”

Sa i përket përgjigjes në padi i autorizuari i paditësve e ka konsideruar si të pabazuar.

Në fjalën përfundimtare i autorizuari i paditësve ka propozuar që kërkesë padia e precizuar të aprovohet si e bazuar. Kamatën ligjore nuk e kërkoi.

Shpenzimet procedurale u kërkuan vetëm sa i përket taksave për padi.

E paditura me përgjigje në padi ka parashtruar se sipas dispozitave ligjore të cilat kanë qenë në fuqi të drejtat dhe detyrimet e personelit të punësuar në Ministrinë e Arsimit janë të rregulluara me Ligjin e Punës nr.03/L-212 i cili nuk ka paraparë asnjë beneficion apo privilegj për personat të cilëve ju ndërprehet marrëdhënia e punës sipas fuqisë ligjore, me mbushjen e moshës së pensionimit.

Ish Ministri i MASHT-it Ramë Buja me kryetarin e SBASHK- ut Rrahman Jasharaj kanë nënshkruar Kontratën Kolektive të Arsimit Parauniversitar ku sipas nenit 2 zbatimi i Kontratës është për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private para universitare në mbarë territorin e Republikës së Kosovës të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut. Në nenin 36 rregullohet garantimi i pagave dhe sipas pikës 9 anëtarët e SBASHK-ut –punëtorët që dalin në pensin përfitojnë shpërblim jubilar siç kanë kërkuar paditësit, por kontrata nuk është e zbatueshme dhe nuk mund të ketë efekt retroaktiv.

Bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të nënshkruar me datë 18 prill 2017 në mes të Arsim Bajrami Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Rrahman Jasharaj Kryetar i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës përkundër nenit 46 të asaj Kontrate, nga ana e MASHT- it dhe SBASHK- ut nuk janë angazhuar për të i informuar dhe ndihmuar Komunitat që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe kostos buxhetore për zbatimin e asaj Kontrate në Ministrinë e Financave me qëllim të realizimit të buxhetit. U propozua që kërkesëpadia e paditësve të refuzohet si e pa bazuar.

Shqyrtimin kryesor të treguar me datën 27 dhjetor 2018 Gjykata e ka mbajtur në mungesë të paditurës të ftuar në mënyrë të rregullt me propozimin e të autorizuarit te paditësve bazuar në nenin 423.4 të LPK.

Për të vendosur në këtë çështje juridike Gjykata bëri nxjerrjen e provave si ; Vendimit ... datë ..., Vërtetimit nr.prot. ... të datës ..., Deklaratës së llogarisë të datës ... për A. S., Vendimit ..., Vërtetimit nr. ... të datës ..., Deklaratës së llogarisë së datës ... për R. M., Vendimit ... datë ..., Vërtetimit nr. ... të datës ... nuk ka vërtetim të përvojës së punës, Deklaratës së llogarisë bankare të P.C. B. datë ... për M. M., Vendimit ... datë ..., vërtetimit pa numër të datës ..., Deklaratës së llogarisë P. C. B. datë ... për G. R., Vendimit ... të datës ..., Vërtetimit nr. ... të datës ..., deklaratës së llogarisë së Bankës P.C.. B. të datës ... dhe konfirmimit të bankës ekonomike ... për Sh. N., Vendimit ... datë ..., vërtetimit nr. ... datë ..., deklaratës së llogaris P.C. B. së datës ... për M. M., Vendimit ... datë ..., vërtetimit nr. ... datë ..., historiatit të llogarisë B. E. të datës ... për J. E. ku pas vlerësimit veç e veç të këtyre provave dhe në lidhshmërinë e tyre reciproke gjeti se kërkesë paditë

e precizuara të paditësve janë të bazuara dhe si të tilla u aprovua, ndërsa janë pjesërisht të bazuar në raport me paditësin e parë dhe paditësen e shtatë.

Nga lista e të pensionuarve, anëtarë të SBASHK-ut në Gjakovë të datës . . . , vërtetohet se paditësit kanë qenë anëtarë të SBASHK-ut.

K. Gj. D. A. paditësit të parë A. S. data e lindjes ... i punësuar në punët dhe detyrat e punës si punëtor tekniko shërbyes në SHFMU “ B. S. ” B. i ndërprejnë kontratën e punës me datë ... për shkak të daljes në pension, mbushjes së moshës 65 vjeç.

Me Vërtetimin e asaj Shkolle është vërtetuar se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune si punëtor tekniko shërbyes dhe ka përvojë pune mbi 14 vite. Pagat neto për muajt janar dhe shkurt 2015 kanë qenë 241.28€. Kjo rrethanë vërtetohet nga deklarata e llogarisë së P.C. b. të datës . . .

Bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit Parauniversitar të lidhur në mes të Kryetarit të SBASHK-ut Rrahman Jasharaj dhe MASHT-it, Ministrit Ramë Buja të datës 11 prill 2014, e cila kontratë për implikimet financiare ka filluar të zbatohet nga data 1 janar 2015 ndërsa dispozitat tjera kanë filluar të zbatohen menjëherë, sipas nenit 51 të asaj Kontrate , paditësit nuk i takon paga përcjellëse për muajin dhjetor 2014 e as për muajin mars 2015 në shumë prej 241.28€ për shkak se të njëjtit me Vendimin e D. për A.–K. e Gj. nr. . . . të datës . . . i është ndërprerë Kontrata e punës me datën . . . , për shkak të daljes në pension dhe refuzoj shumën në vlerë të një page në lartësi 241,28 € dhe aprovoj shumat për dy muaj janar dhe shkurt 2015 nga 241,28 €.

Paditësit bazuar në përvojën e punës së tij mbi 14 vite i takon një pagë bazuar në nenin 36 pika 9.1 të Kontratës së lartë shënuar.

K. Gj. D. A. paditëses së dytë R. M. data e lindjes . . . e punësuar në punët dhe detyrat e punës si arsimtare e mësimi klasor në SHFMU “A. “ R. i ndërprejnë kontratën e punës me datë ... për shkak të daljes në pension dhe mbushjes së moshës 65 vjeç.

Nga Vërtetimet e SHFMU “ A. ” R. vërtetohet se paditësja R. ka punuar në atë shkollë nga data . . . e deri me . . . dhe ka mbi 42 vite përvojë pune. Pagat bruto për muajt prill, maj qershor 2016 kanë në shumë prej 527.04€.

Nga Deklarata e llogarisë e P.C. b. e datës . . . vërtetohet se e njëjta ka realizuar pagat për tre muajt e fundit para pensionimit për muajt prill , maj dhe qershor 2016 shumën 470.46€ (paga neto)nga u vërtetua lartësia e kërkesëpadisë .

K. Gj. D. A. paditëses së tretë M. M. data e lindjes ... e punësuar në punët dhe detyrat e punës si mësimdhënëse në SHFMU “ D. A. “ D. 1 i ndërprejnë kontratën e punës me datë ... për shkak të daljes në pension, mbushjes së moshës 65 vjeç.

Nga Vërtetimin e asaj Shkolle vërtetohet se paditësja ka qenë në marrëdhënie pune nga data . . . dhe ka mbi 30 vite përvojë pune.

Nga Historiati i llogarisë së P.C. b. . . . , për paditësen M. lidhur me ekzekutimin e pagave për prill, maj, qershor 2016 kanë qenë në shumë prej 445.31€ nga u vërtetua shuma e pagës bazë.

K. Gj. D. A. paditëses së katërt G. R. data e lindjes ... e punësuar në punët dhe detyrat e punës si mësimdhënëse në SHFMU “ E. D. “ Gjakovë i ndërprente kontratën e punës me datë ... për shkak të daljes në pension, mbushjes së moshës 65 vjeç.

Nga Vërtetimin e asaj Shkolle vërtetohet se paditësja ka qenë në marrëdhënie pune nga data ... e deri me ... dhe ka mbi 43 vite përvojë pune. Të ardhurat personale muajt e fundit kanë qenë në shumë prej 553.12€.

Nga Historiati i llogarisë së P.C. b. datë ..., për paditësen G lidhur me ekzekutimin e pagave për shkurt, mars dhe prill 2016 kanë qenë në shumë prej 473.91€ nga u vërtetua shuma e pagës bazë.

K. Gj. D. A. paditëses të pestë Sh. N. data e lindjes ... e punësuar në punët dhe detyrat e punës si mësimdhënëse në SHFMU “ F. N.” D. i ndërprente kontratën e punës me datë ... për shkak të daljes në pension dhe mbushjes së moshës 65 vjeç.

Me Vërtetimin e asaj Shkolle vërtetohet se paditësja Shkurte ka mbi 30 vite përvojë pune.

Nga Historiati i llogarisë së P.C. B. datë ... lidhur me ekzekutimin e pagave për muajt prill, maj qershor 2016 vërtetohet se pagat neto kanë qenë në shumë prej 459.09€ ndërkaq nga paditësja janë kërkuar shumat prej 462.00€ për tri pagat përcjellëse dhe pagat mesatare të shpërblimit jubilar në shumën prej 405.00€, nga u vërtetua lartësia e kërkesës së parashtuar.

K. Gj. D. A. paditëses së gjashtë M. M. data e lindjes ... e punësuar në punët dhe detyrat e punës si pastruese në Qerdhën “G. T.” në Gjakovë, i ndërprente kontratën e punës me datë 31 maj 2016 për shkak të daljes në pension dhe mbushjes së moshës 65 vjeç.

Me Vërtetimin i shkollës I.P. “G. T.” në Gjakovë, vërtetohet se paditësja M. ka qenë në cilësi të pastrueses pranë atij institucioni nga data Paga mujore neto për muajt mars, prill, maj ka qenë në shumë prej 273.63€. dhe ka mbi 32 vite përvojë pune.

Nga Qarkullimi për llogarinë, P.C. B. të datës ... lidhur me ekzekutimin e pagave për muajt mars, prill dhe maj 2016 kanë qenë në shumë prej 273.63€ nga u vërtetua lartësia e kërkesës padisë.

K. Gj. D. A. paditëses së shtatë J. E. data e lindjes ... e punësuar në punët dhe detyrat e punës si serviore në Qerdhën “ G. T ” në Gjakovë, i ndërprente kontratën e punës me datë ... për shkak të daljes në pension dhe mbushjes së moshës 65 vjeç.

Nga Vërtetimi i I.P.”G. T.” Gjakovë vërtetohet se paditësi J. ka qenë në marrëdhënie punë pranë atij institucioni në cilësinë e serviuere nga ... deri me ... dhe ka mbi 32 vite përvojë pune. Pagat për tre muajt e fundit kanë qenë 274.65€.

Nga Historia i llogarinë së Bankës ekonomie SHA Prishtinë të datës ... lidhur me ekzekutimin e pagave për muajt gusht, shtator, tetor 2016 pagat kanë qenë në shumë prej 274.65€ nga u vërtetua lartësia e kërkesës padisë.

Gjykata aprovoj shumat e pagave përcjellëse dhe shpërblimit jubilar bazuar në lartësinë e kërkesave të parashtuara dhe vërtetimit të lartësisë së tyre nga provat e administruara.

Sipas Kontratës Kolektive të Arsimit Parauniversitar që ka hyrë në fuqi me datë . . . e lidhur në mes të Kryetarit të SBASHK- ut dhe Ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), e cila Kontratë për implikimet financiare sipas nenit 51) dispozitat e kësaj Kontrate kanë filluar të zbatohet nga data 01 janar 2015 që ka efekt juridik në këtë çështje lëndore.

Sipas nenit 36 pika 9 të Kontratës punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) që dalin në pension përfitojnë shpërblim jubilar në vlerë;

- 9.1 për 10 vjet të përvojës së punës te punëdhënësi i fundit në vlerë të një page bazë,
- 9.2 për 20 vjet të përvojës së punës te punëdhënësi i fundit në vlerë të dy pagave bazë,
- 9.3 për 30 vjet të përvojës së punës te punëdhënësi i fundit në vlerë të tri pagave bazë,
- 9.4 punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblimin jubilar,
- 9.5 shpërblimi jubilar paguhet në afat prej një muaji pas plotësimit të kushteve.

10. punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) që dalin në pension përfitojnë pagesë përcjellëse në lartësi prej tri pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit nga u vërtetua baza e kërkesëpadisë.

Gjykata vlerësoj pretendimet e palës së paditur mirëpo të njëjtat janë të pa qëndrueshme për faktin se paditësit janë pensionuar gjatë vitit 2015-2016. Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e lidhur në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës është lidhur me 11 prill 2014 e cila është e aplikueshme në këtë çështje lëndore. Kontrata Kolektive e Arsimit Parauniversitar e lidhur në mes të Ministrisë së Arsimit e Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës së Kosovës ka hyrë në fuqi me datë 11 prill 2014 e që sa i përket implikimeve financiare ka filluar të zbatohet nga data 01 janar 2015 dhe nuk ka të bëjë me çështjen e shfuqizuar me nenin 48 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18 prill 2017 . Sa i përket planifikimit të buxhetit për pagat e tilla paditësit nuk mund të pësojnë lidhur me planifikimin e buxhetit dhe kostos buxhetore për zbatimin e kësaj Kontrate nga e organeve shtetërore. Andaj, pretendimet e tilla ishin pa ndikim në vendosjen ndryshe të çështjes, nga se nuk kishin mbështetje ligjore.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u murr bazuar në nenin 452.1 të LPK- së, ku pala e paditur ka detyrim në pagesën e shpenzimeve gjyqësore për taksë gjyqësore në shumat e cekura si në dispozitiv të Aktgjykimit.

Nga sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË
C.nr. 691/ 18 , datë 27 dhjetor 2018

Gj y q t a r j a,
Afijete Sada Gllogjani

UDHËZIM JURIDIK kundër këtij Aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, pas marrjes së tij Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë nëpërmjet kësaj Gjykate.